

# TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

## Përmbajtja

- I. Seminari i të premtes
- II. Punët kërkimore të sapopërfunduara
- III. Materiale diskutimi në proces
- IV. Artikuj
- V. Aktivitete të tjera

## I. SEMINARI I TË PREMTES

Tematika e materialeve të prezantuara gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2012, në aktivitetin kërkimor "Seminaret e së Premtes" kanë të bëjnë kryesisht me modelet e parashikimit, politikën fiskale, kreditimin, performancën e eksporteve, perceptimin e konsumatorëve ndaj instrumenteve të pagesës etj. Në rubrikën më poshtë do të gjeni një përmbledhje më të detajuar të këtyre materialeve.

### **"HULUMTIMI EMPIRIK I PASIGURISË SË PARASHIKIMIT ME SIMULIMIN MONTE CARLO", - NGA ALTIN TANKU, ELONA DUSHKU DHE KLITI CECA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Materiali vlerëson performancën e termit të gabimit të parashikimit në modelin MEAM, me anë të teknikave Monte Carlo të simulimit stokastik. Rezultatet e marra tregojnë se: vlerësimet stokastike të gjeneruara nga modeli nuk kanë diferencë të mëdha me vlerësimet deterministike, pra modeli është linear në terma të parashikimeve; modeli nuk është shumë i ndjeshëm ndaj goditjeve të jashtme dhe përdorimi i

parashikimeve stokastike është më i mirë përkundrejt vlerësimeve deterministike. Një ndër konkluzionet kryesore është se parashikimet makroekonomike janë shumë të rëndësishme, por të kuptuarit e burimeve të pasigurisë është akoma më i rëndësishëm gjatë procesit të vendimmarrjes dhe analizimit të efekteve të ndryshme makroekonomike.

### **"POLITIKA FISKALE DHE RITJA EKONOMIKE: RASTI I SHQIPËRISË", - NGA GERTI SHIJAKU (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE ARLIND GJOKUTA (DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE)**

Materiali i diskutimit analizon ndikimin e politikës fiskale në rritjen ekonomike, në rastin e një vendi të vogël të hapur dhe në zhvillim si Shqipëria, duke u bazuar në përafrimin empirik të metodës GMM (*Generalized Method of Moments*). Kjo metodë lejon që me anë të përdorimit të variablave instrumentale të arrihet të shuhet problemi i endogjenitetit midis variablave fiskale dhe rritjes ekonomike. Impakti i të ardhurave dhe shpenzimeve

në rritjen ekonomike është analizuar duke i ndarë të ardhurat tatimore në shtrembëruese dhe jo-shtrembëruese, ndërsa shpenzimet janë ndarë në produktive dhe joproduktive. Rezultatet tregojnë që rritja ekonomike ndikohet pozitivisht nga shpenzimet qeveritare produktive dhe negativisht nga shpenzimet joproduktive, si dhe tatimi shtrembërues ka efekt më të madh në reduktimin e rritjes.

**“ÇMIMET E SHTËPIVE DHE KREDIA HIPOTEKARE NË SHQIPËRI”, - NGA ERJONA SULJOTI DHE GENT HASHORVA (DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE)**

Studimi hulumton faktorët që kanë ndikuar në dinamikën e çmimeve të shtëpive, me fokus kryesor rolin e kredisë hipotekare. Bazuar në Modelet Dinamike të Katrorëve më të Vegjël, autorët gjejnë një lidhje statistikisht të rëndësishme ndërmjet kredisë hipotekare dhe çmimeve të shtëpive në Shqipëri. Gjithashtu, studimi tregon se faktorë të tjerë që kontribuojnë në formimin e çmimeve janë: indeksi i kushtimit në ndërtim dhe të ardhurat. Megjithatë, duke marrë parasysh faktorët që pengojnë funksionimin normal të tregut të pasurive të patundshme dhe faktin që Shqipëria është një ekonomi në zhvillim, autorët besojnë se të dy treguesit (çmimet e shtëpive dhe kredia hipotekare) janë subjekt i ndryshimeve dinamike në procesin e përshtatjes me nivelet e reja të ekuilibrit në të ardhmen.

**“SJELLJA E KREDITIMIT NË SHQIPËRI: NJË SHENJË KONVERGJENCE APO DEVIJIM NGA TENDENCA E VET AFATGJATË?”, - NGA IRINI KALLUCI, (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky material synon të studiojë sjelljen e kreditimit të ekonomisë shqiptare dhe të vlerësojë luhatjet që ajo ka pësuar sidomos gjatë dekadës së fundit. Zhvillimet e rritjes së shpejtë të kredisë gjatë viteve 2004-2008 në Shqipëri, por edhe ngadalësimi i menjëhershëm që pësoi ajo pas vitit 2008, janë çështje të rëndësishme që meritojnë një analizë më të thellë, jo vetëm nga pikëpamja e stabilitetit makroekonomik, por edhe e atij të sistemit financiar. Për këtë arsye, në këtë punim janë përdorur metoda statistikore e ekonometrike për identifikimin e një niveli “ekuilibër” për treguesin kredi ndaj PBB-së, në rastin e Shqipërisë.

**“SISTEMET E PENSIONEVE”, - NGA BORA ANGJELI (FITUESE E VENDIT TË PARË TË ÇMIMIT TË GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2011)**

Studimi përpiqet të paraqesë problematikat e sistemeve të pensioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u fokusuar në aspektin social dhe ekonomik. Ndër konkluzionet kryesore të këtij materiali është që skema aktuale e pensioneve ka nevojë të ristrukturohet, dhe të kalohet drejt një sistemi pensionesh me shumë shtylla, që merr parasysh karakteristikat dhe specifikat e grupeve të ndryshme shoqërore.

**“PËRDORIMI I MODELEVE MAKROEKONOMETRIKE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES SË POLITIKËS MONETARE”, - NGA STEFAN LASÉEN, DAN NYBERG DHE INGVAR STRID (BANKA QENDRORE E SUEDISË)**

Fokusi kryesor i prezantimit ishte përdorimi i modeleve në procesin e vendimmarrjes së politikës monetare

dhe derivimi i parashikimeve, simulimeve apo i analizave të ndryshme të politikave monetare. Më tej, ekonomistët e Bankës së Suedisë u ndalën në mënyrën se si gjykimi i ekspertëve kombinohej me rezultatet e gjenerura nga modelet (empirike dhe teorike) për të konkluduar në një parashikim të vetëm kryesor. Me interes ishte dhe procesi i rishikimit të projeksionit qendror në varësi të ndryshimeve të parashikimeve apo supozimeve për variablat e caktuar.

#### **“SJELLJA FISKALE DHE KURBA E YIELD-EVE NË SHQIPËRI”, - NGA ESIDA ABAZAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Një tjetër aspekt i hulumtimit të politikës fiskale në treguesit kryesorë makroekonomikë është nëpërmjet ndikimit të tyre në normat e interesit dhe në variablat e tjerë. Ky material synon të studiojë sjelljen e politikës fiskale dhe të kurbës së *yield-eve* gjatë periudhës 2001-2010, duke përdorur modelin VAR (*Modeli i Vektorëve Autoregresivë*). Treguesit fiskalë të përfshirë në model janë normat vjetore të ndryshimit të borxhit në përqindje ndaj PBB-së dhe bilanci fiskal në përqindje ndaj PBB-së, ndërsa kurba e *yield-eve* përfaqësohet nga dy faktorët e vet (niveli dhe pjerrësia), të cilët janë llogaritur nga shprehje standarde matematikore. Analiza e IRF-së (*Impulse Response Functions*) jep një informacion më të detajuar mbi mënyrën se si goditjet në zhvillimet fiskale ndikojnë kurbën e *yield-eve*, gjatë periudhës së marrë në shqyrtim.

#### **“QEVERISJA E KORPORATAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR: ANALIZË E ANKETIMIT TË KRYER**

#### **PËR QEVERISJEN E KORPORATAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR (2011)”, - NGA IRINI KALLUCI, ORIELA KODRA, KLITI CECA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE), ARZANA HAXHIAJ (DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE), LINDITA SHEHI DHE BESJANA BREGASI (DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES) (MATERIAL KONFIDENCIAL)**

Ky punim i dytë vjen në vazhdimësi të materialit me të njëjtin titull të realizuar gjatë vitit 2010. Në kuadër të rëndësisë së zhvillimit të sektorit bankar në Shqipëri, ky punim synon të vlerësojë cilësinë e qeverisjes së bankave në vend, nëpërmjet matjes së indeksit të përgjithshëm të qeverisjes bankare dhe disa nënindekseve të tij. Punimi paraqet edhe një analizë teorike e statistikore të elementëve të ndryshëm të qeverisjes bankare, si dhe identifikon çështje e problematika që hasen në mënyrën e drejtimit, organizimit e funksionimit të bankave, rezultate këto të nxjerra nga anketimi i drejtuar tek të gjitha bankat e sistemit.

#### **“PERCEPTIMI I INSTRUMENTEVE TË PAGESËS NGA KONSUMATORËT SHQIPTARË – NJË ANKETIM PUBLIK”, - NGA KLITI CECA, ALBAN PLLAHA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE), DHE VALENTINA SEMI (DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE)**

Ky material kishte për qëllim prezantimin e rezultateve kryesore të anketimit të kryer nga Banka e Shqipërisë, për të identifikuar përdorimin e instrumenteve të pagesave nga individët në Shqipëri, bazuar në karakteristikat specifike që mbarte secili prej tyre. Anketimi u realizua në zonën Tiranë – Durrës, ku ndodhet

e përqendruar pjesa më e madhe e popullatës, dhe përfshinte individë që dispononin një llogari bankare.

**“PERFORMANCA E EKSPORTEVE TË MALLRAVE SHQIPTARE GJATË PERIUDHËS 2005-2011”, - NGA OLTİ MITRE (DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE)**

Ky studim synon të vlerësojë ecurinë e eksporteve shqiptare gjatë periudhës 2005-2011, duke studiuar së pari strukturën e mallrave dhe orientimin gjeografik të tyre, së dyti duke parë ekspozimin e ekonomisë shqiptare drejt tregtisë së huaj, dhe së treti duke identifikuar faktorët kryesorë që kanë ndikuar strukturën degësore dhe gjeografike të eksporteve, nëpërmjet metodës CMS (*Constant Market Share*). Rezultatet e marra tregojnë që ecuria e eksporteve tona për periudhën e marrë në analizë vlerësohet e kënaqshme. Struktura e mallrave të eksportit gjatë periudhës 2005-2010 u vlerësua të ketë sjellë efekt negativ, ndonëse në rënie, në

ritjen totale të eksporteve. Megjithëse riorientimi i eksporteve shqiptare drejt vendeve anëtare të CEFTA-s vlerësohet të ketë qenë pozitiv, efekti i lartë që dha rënia e kërkesës për mallra të huaja në vendet e BE-së, ka ndikuar negativisht edhe ecurinë e eksporteve shqiptare gjatë periudhës në analizë.

**“NDËRTIMI I NJË TREGUESI PARAPRIRËS TË PËRBËRË PËR SHQIPËRINË”, - NGA ERMELINDA KRISTO DHE DELINA IBRAHIMAJ (DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE)**

Synimi i këtij materiali është ndërtimi i një treguesi të përbërë paraprirës (TPP) për rastin e Shqipërisë, i cili është statistikisht i rëndësishëm për të analizuar dhe parashikuar një tregues makroekonomik ose seri referencë. Ndërtimi i TPP-së siguron informacion paraprak për ecurinë e ekonomisë me disa tremujorë avancë duke sinjalizuar pikat potenciale të kthesës. Gjithashtu, ky tregues mund të përdoret dhe për parashikim sasior.

## II. PUNËT KËRKIMORE TË SAPOPËRFUNDUARA

**“RAPORT I ANKETIMIT MBI PËRDORIMIN E INSTRUMENTEVE TË PAGESËS – INDIVIDËT. SHKURT – MARS 2012”, - NGA KLITI CECA, ALBAN PLLAHA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE), DHE VALENTINA SEMI (DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE).**

Ky anketim synon identifikimin e karakteristikave të individëve të cilat ndikojnë pozitivisht ose negativisht në përdorimin e instrumenteve të pagesave

nga ana e tyre. Anketimi u mundësua nga Banka e Shqipërisë, u konceptua dhe u përpunua nga Departamenti i Kërkimeve, mbështetur nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe nga Departamenti i Statistikës, si dhe u realizua në terren nga INSTAT-i. Anketimi u realizua në zonën Tiranë – Durrës, me rreth 200 individë që disponojnë një llogari bankare. Disa prej konkluzioneve dhe sugjerimeve kryesore të kësaj ankete janë: analizimi i rezultateve dhe karakteristikave të evidentuara sugjerojnë se rritja e nivelit të

arsimit krijon kushte dhe rrit mundësitë e përdorimit të instrumenteve të pagesave; llogaria bankare ka një tendencë më të lartë të përdorimit “të thjeshtë” (për tërheqje të parasë së gatshme apo përdorim të cash-it), sesa për t’u përdorur si instrument pagese shumëfunktional; përgjithësisht sistemi i ofrimit të instrumenteve të pagesës vlerësohet me nota të larta.

**“QEVERISJA E KORPORATAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR - ANALIZË E VITIT 2011”, - NGA IRINI KALLUCI, ORIELA KODRA, KLITI CECA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE), ARZANA HAXHIAJ (DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE), LINDITA SHEHI DHE BESJANA BREGASI (DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES)**

Ky material vjen i dyti në vazhden e punimeve që po përgatiten për qeverisjen bankare në Shqipëri. Qëllimi kryesor është matja e Indeksit të Qeverisjes Bankare (IQB) për vitin 2011, por edhe realizimi i një analize përshkruese për aspektet e qeverisjes, mangësitë e vërejtura si dhe identifikimin e fushave ku mund të ketë nevojë për një ndërhyrje të mundshme nga ana e mbikëqyrësve për të korigjuar këto mangësi. Për realizimin e analizës dhe matjen e vlerave të indeksit u përdorën vërtetimet e kryera në bankat tregtare gjatë vitit 2011, të cilat

përfshijnë pyetje bazuar në Parimet e BIS dhe praktikat më të mira, që përshtaten edhe me ambientin bankar shqiptar.

**“POLITIKA FISKALE DHE IMPLIKIMI I SAJ NË NJË EKONOMI TË VOGËL E TË HAPUR, ME TË DHËNA TË KUFIZUARA - RASTI I SHQIPËRISË”, - NGA ALTIN TANKU DHE ELONA DUSHKU (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky material është një përmbledhje e punës kërkimore të Bankës së Shqipërisë në drejtim të vlerësimit të politikës fiskale gjatë periudhës 1998-2011. Bazuar në rezultatet e marra, mund të themi se gjatë kësaj periudhe tranzicioni, politika fiskale ka kaluar nëpër disa faza të ndryshme zhvillimi e shoqëruar me reforma të ndryshme strukturore. Një ndër sugjerimet e materialit është që një pozicion i shëndoshë fiskal është një parakusht për një rritje më të lartë ekonomike, ku zbalancimet e ulëta fiskale shoqërohen me një qëndrueshmëri më të madhe ekonomike, dhe rritje të klimës së investimeve. Për të siguruar një qëndrueshmëri të politikës fiskale, jo vetëm në periudhën afatshkurtër, por edhe në periudhën afatgjatë kërkohet fillimisht një komunikim i qartë i politikave dhe objektivave nga secili prej agjentëve ekonomikë që veprojnë në treg, si dhe koordinimi i punës midis tyre.

### III. MATERIALE DISKUTIMI NË PROCES

**“EFEKTI I KURBËS-J. NDIKIMI I KURSIT TË KËMBIMIT NË BILANCIN TREGTAR DYPALËSH: RASTI I SHQIPËRISË”, - NGA ALBAN PLLAHA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky studim ka për qëllim të vlerësojë nëse nënçmimi i monedhës vendase (Lekut) ka ndikim në përmirësimin e bilancit tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë tregtarë.

Studimi do të trajtojë ndikimin e kursit të këmbimit në shkëmbimet tregtare dypalëshe të Shqipërisë me partnerët e saj kryesorë si Italia, Greqia, Gjermania, Turqia dhe Kosova. Vlerësimet do të bëhen duke përdorur të dhëna me frekuencë tremujore për periudhën 1998–2012. Synimi i vlerësimeve është të kapë efektet afatshkurtra dhe afatgjata që ka nënçmimi i monedhës vendase në bilancin tregtar, duke përdorur metodat “ECM” dhe “ARDL”.

**“RAPORT I ANKETIMIT MBI PËRDORIMIN E INSTRUMENTEVE TË PAGESËS – BIZNESET. SHKURT - MARS 2012”, - NGA KLITI CECA, ALBAN PLLAHA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE VALENTINA SEMI (DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE)**

Ky anketim synon identifikimin e karakteristikave të bizneseve, të cilat ndikojnë pozitivisht ose negativisht në përdorimin e instrumenteve të pagesave nga ana e tyre. Anketimi u mundësua nga Banka e Shqipërisë, u konceptua dhe u përpunua nga Departamenti i Kërkimeve, mbështetur nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe nga Departamenti i Statistikës si dhe u realizua në terren nga INSTAT. Anketimi u realizua në zonën Tiranë – Durrës, drejtuar gjithsej 400 bizneseve, ku gjysma e tyre pranojnë pagesa nëpërmjet instrumenteve bankare jo-cash dhe gjysma tjetër nuk pranojnë pagesa me instrumente të tilla. Disa prej analizave që janë duke u realizuar janë: ndikimi i madhësisë së biznesit në përdorimin e instrumenteve; si ndikohet përdorimi dhe perceptimi i instrumenteve të pagesave nga lloji i bizneseve; ndikimi i xhiros mesatare të realizuar nga biznesi

në përdorimin e instrumenteve; disa nga faktorët kryesorë që udhëheqin bizneset në përdorimin e këtyre instrumenteve etj.

**“PËRCAKTUESIT E KREDISË BANKARE PËR SEKTORIN PRIVAT – RASTI I SHQIPËRISË”, NGA GERTI SHIJAKU DHE IRINI KALLUCI (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky material fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e përcaktuesve afatgjatë të kredisë së bankave për sektorin privat në rastin e Shqipërisë, duke përdorur një Mekanizëm të Vektorit të Korrigjimit të Gabimit (VECM), bazuar në tregues të kërkesës dhe ofertës. Studimi fokusohet në të dhëna tremujore përgjatë periudhës 2001-2011. Rezultatet tregojnë se ekziston një mekanizëm korrigjimi që e kthen kreditimin drejt nivelit ekuilibër. Të tjera gjetje paraqesin lidhjen pozitive të kreditimit me rritjen ekonomike, ku ndërmjetësimi financiar, ashtu si edhe liberalizimi financiar stimulojnë një kërkesë më të lartë për kredi. Gjithashtu, kostot më të ulëta të kredisë, rënia e huamarrjes së brendshme të qeverisë dhe një cilësi më e lartë e portofolit të kredisë, do të krijojnë më shumë nxitje për kreditim. Njëkohësisht, kursi i këmbimit kap efektet e kërkesës dhe të zbutjes së konsumit.

**“MATJA E PRODUKTIVITETIT TË BANKAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR”, - NGA IRINI KALLUCI (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky studim synon të paraqesë metodologjinë e vlerësimit dhe të masë nivelin e produktivitetit të bankave që operojnë në Shqipëri, duke përdorur 2 metoda bazë që njihen në literaturë:

Metodën e Ndërmjetësimit dhe Metodën e Prodhimit, të cilat i shikojnë aktivet dhe pasivet e bankave nga këndvështrime të ndryshme, herë si *input*-e dhe herë si *output*-e. Një matje e tillë e produktivitetit do të ofrojë mundësinë e vlerësimit të produktivitetit të bankave, si dhe të atyre faktorëve të produktivitetit të cilëve iu duhet kushtuar më tepër vëmendje edhe nga ana e mbikëqyrësve.

#### **“VLERËSIMI I ELASTICITETEVE TË IMPORTEVE DHE EKSPORTEVE - RASTI I SHQIPËRISË”, - NGA BLEDAR HODA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Treguesit e llogarisë së jashtme të një ekonomie të hapur reagojnë ndaj stimujve sasiore dhe treguesve të çmimeve relative. Ecuria e kërkesës agregate dhe e kushteve të tregtisë janë dy faktorë që literatura sugjeron se ndikojnë ecurinë e tyre. Në këtë material synohet vlerësimi i elasticiteteve të importeve dhe eksporteve të Shqipërisë ndaj treguesve të PBB-së dhe kursit të këmbimit. Ky i fundit, si dhe kostot për njësi të dy vendeve në marrëdhënie tregtare me njëra-tjetrën,

janë ndër faktorët kryesorë që përcaktojnë kushtet e tregtisë. Vlerësimi i elasticiteteve mundëson një analizim alternativ të zhvillimeve të llogarisë së jashtme në prani të cikleve të bizneseve.

#### **“SINKRONIZIMI I CIKLEVE TË BIZNESIT PËR VENDET E RAJONIT: NJË STUDIM ME METODËN SVAR”, - NGA ENDRIT YZEIRAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky studim përpiqet t'i japë përgjigje pyetjes “Sa të integruara janë ekonomitë e vendeve të rajonit me njëra-tjetrën?”. Integrimi i ekonomive të rajonit si dhe krijimi i një ekonomie rajonale është parë si një hap i rëndësishëm zhvillimi për të gjitha vendet e përfshira. Por shkalla e integritit të këtyre ekonomive ka qenë përherë e paqartë. Duke përdorur metodën e propozuar nga Blanchard dhe Quah, studimi tenton të shpërbëjë ciklet e biznesit sipas goditjeve të ardhura nga sektorët e ofertës dhe kërkesës. Korrelacionet e përfuturara nga këto seri të reja përdoren për të krijuar një ide më të qartë për shkallën e sinkronizimit e për rrjedhojë të integritit të ekonomive rajonale.

## **IV. ARTIKUJ**

Në këtë rubrikë do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të disa materialeve të publikuara nga banka të tjera qendrore gjatë periudhës janar-qershor 2012, për të dhënë një pasqyrë më të qartë mbi temat kërkimore shkencore të publikuara nga institucione dhe banka të tjera qendrore.

#### **“SA FLEKSIBËL MUND TË JETË INFLACIONI I SHËNJESTRUAR**

#### **DHE SËRISH TË FUNKSIONOJË”, - NGA KENNETH N. KUTTNER (DEPARTAMENTI I EKONOMIKSIT I WILLIAMS COLLEGE DHE NBER) DHE ADAM S. POSEN (INSTITUTI PETERSON I EKONOMIKSIT NDËRKOMBËTAR DHE KOMITETI I POLITIKËS MONETARE, BANKA E ANGLISË)**

Ky material shqyrton fleksibilitetin e regjimit të inflacionit të shënjestruar,

me qëllim të veçantë përcaktimin nëse politika monetare e Bankës së Anglisë, e cila ka si objektiv zyrtar inflacionin, ka qenë më pak elastike sesa Rezerva Federale e SHBA-së, e cila nuk e ka një objektiv të tillë. Analiza empirike përdor shpejtësinë e inflacionit të parashikuar nga parashikuesit profesionalë, të dhënë prej tyre në horizonte parashikimi të njëpasnjëshme, për të vlerësuar fleksibilitetin e perceptuar të reagimit të bankës qendrore në përgjigje të goditjeve makroekonomike. Bazuar në këtë kriter, nuk gjenden evidenca që të tregojnë që objektivi që ka Banka e Anglisë, ta ketë detyruar atë të jetë më agresive ndaj inflacionit të ulët, sesa Rezerva Federale.

**“POLITIKA FISKALE DHE RECESIONI I MADH NË ZONËN E EUROS” - NGA GUNTER COENEN, ROLAND STRAUB DHE MATHIAS TRABANDT ( BANKA QENDRORE EVROPIANE)**

Ky material ka si qëllim hulumtimin e kontributit të politikës fiskale në rritjen reale të PBB-së në zonën e euros gjatë krizës së fundit financiare, duke patur parasysh rëndësinë që luajnë ato në rritjen ekonomike. Pjesa më e madhe e diskutimeve synon të kuantifikojë madhësinë dhe ndjeshmërinë e koeficientëve fiskalë që lidhen me lançimin e paketave të shumta fiskale. Në këtë material, në kontrast edhe me studime të tjera autorët japin një vlerësim sasior *ex-post* të efektivitetit që politikat fiskale diskrecionare ndikojnë ciklin e biznesit të zonës së euros gjatë krizës. Autorët vlerësojnë se masat diskrecionare fiskale kanë ndikuar në rritjen tremujore të vjetorizuar të PBB-së gjatë periudhës së krizës me 1.6 pp. Autorët kanë përdorur një model më të zgjeruar të Bankës

Qendrore Evropiane me një specifikim më të pasur të sektorit fiskal për të vlerësuar këtë efekt.

**“KURBA TRADICIONALE PËRKUNDREJT KURBËS NEO-KEJNESIANE TË FILIPSIT: EVIDENCË NGA EFEKTET E PRODHIMIT” - NGA WERNER ROEGER (KOMISIONI EUROPIAN) DHE BERNHARD HERZ (UNIVERSITETI I BAYREUTH)**

Autorët identifikojnë një diferencë të rëndësishme midis kurbës *backward-looking* dhe asaj *forward-looking* të Filipsit duke marrë në konsideratë efektet reale në prodhim, që kanë goditjet e politikës monetare. Kurba *backward-looking* e Filipsit parashikon një lidhje strikte përsa i përket goditjeve të politikës monetare; një përgjigje pozitive e prodhimit në afatin e shkurtër shoqërohet nga një periudhë ku prodhimi është poshtë nivelit bazë dhe efekti i akumuluar në prodhim është saktësisht zero. Ndërsa, kurba *forward-looking* e Filipsit parashikon një efekt të akumuluar pozitiv në prodhim. Evidenca empirike tregon se efekti i akumuluar në prodhim që rezulton nga paraqja, është në përputhje me modelin ku kurba e Filipsit është *forward-looking*.

**“MIJËRA MODELE, NJË HISTORI: ÇEKUILIBRA TË LLOGARISË KORRENTE NË EKONOMINË GLOBALE”, - NGA MICHELE CA’ZORSI, ALEKSANDER CHUDIK DHE ALISTAIR DIEPPE (BANKA QENDRORE EVROPIANE)**

Kriza globale financiare ka çuar në një ringjallje të literaturës empirike mbi çekuilibrat e llogarisë korrente. Ky material kontribuon në këtë literaturë nëpërmjet vlerësimit të rëndësisë të modelit dhe



të pasigurisë së parametrave, përpara arritjes së një konkluzioni përfundimtar. Autorët zhvillojnë tre strategji alternative ekonometrike; ekzaminimin e të gjitha modeleve, zgjedhjen e disa prej tyre dhe kombinimin e të gjithëve. Nga një

mijë (apo me të vërtetë miliona) modele, del në pah një histori. Përpara krizës financiare, pozicioni i llogarive korrente të ekonomive të mëdha si SHBA, Angli, Japoni dhe Kinë nuk ishte në linjë me faktorët bazë makroekonomikë.

## V. AKTIVITETE TË TJERA

### **KURSI DYJAVOR ME TEMË: "ADMINISTRIMI I NJË ANKETIMI PROFESIONAL DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE TË TIJ BAZUAR NË EXCEL DHE SPSS"**

Gjatë periudhës maj-qershor të vitit 2012, u organizua nga Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Bankare, Banka e Shqipërisë, me lektor Kliti Cecën, nga Departamenti i Kërkimeve një seri leksionesh me temë "Administrimi i një anketimi profesional dhe përpunimi i të dhënave të tij bazuar në Excel dhe SPSS".

Qëllimi kryesor i këtij kursi ishte marrja e njohurive bazë të stafit të Bankës së Shqipërisë, kryesisht të Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit, dhe të Departamentit të Kërkimeve, mbi të ashtuquajturin "anketim profesional". Në këtë kurs dyjavor u trajtuan konceptet bazë të organizimit të një anketimi, duke filluar që nga organizimi i pyetjeve dhe logjikës që ekziston pas tyre, pritshmëritë mbi anketën, si dhe përpunimi i rezultateve, etj.

Gjithashtu në këtë kurs u zhvilluan edhe njohuritë mbi përdorimin e programeve si SPSS dhe Excel, me qëllim marrjen e njohurive përsa i përket hedhjes së të dhënave të anketës, analizimin, marrjen

e vlerësimeve empirike mbi rezultatet e dhëna, si dhe interpretimit të tyre.

### **SEMINARI I NIVELIT TË LARTË MIDIS UNIVERSITETIT TË OKSFORDIT DHE BANKËS SË SHQIPËRISË, 14 QERSHOR 2012, TIRANË**

Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Universitetin e Oksfordit, organizoi më datë 14 qershor 2012, seminarin e nivelit të lartë me temë: "Evropa Juglindore: Parakushtet për Reforma".

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin guvernatorë dhe zëvendës guvernatorë nga bankat qendrore rajonale, përfaqësues nga sistemi bankar, institucione shtetërore dhe organizma ndërkombëtarë në Shqipëri, si dhe përfaqësues nga Banka e Shqipërisë. Seminari u organizua në vazhdim të aktiviteteve të përbashkëta me Universitetin e Oksfordit, pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit, nënshkruar në shtator të vitit 2010 midis Bankës së Shqipërisë dhe këtij universiteti.

Tematika kryesore e seminarit u përqendrua në zhvillimet aktuale të ekonomive të rajonit, efekti krizë në këto ekonomi, sfidat me të cilat do të përballen, si dhe reformat apo iniciativat

që duhet të ndërmerren jo vetëm në të tashmen, por edhe në të ardhmen. Fokus të veçantë në diskutime kishte vazhdimësia e reformave në ekonomi, hapësirat e mëtejshme fiskale, si dhe thellimi i mëtejshëm i reformave të gjithanshme strukturore. Koordinimi më i mirë mes politikave ekonomike dhe financiare është bërë i domosdoshëm për të garantuar stabilitetin e mëtejshëm makroekonomik të rajonit. Një argument tjetër ishte dhe roli i ankorave të jashtme dhe të brendshme, si dhe mekanizmat kryesorë që do të bëjnë axhustimin, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendeve tona drejt stabilitetit makroekonomik e stabilitetit financiar.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani në fjalën e tij, u shpreh se Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të kujdeset për stabilitetin makroekonomik dhe atë financiar të vendit, të cilat si dy shtylla jetike për qëndrueshmërinë dhe prosperitetin e ekonomisë kanë dhënë kontributin më të mirë në zhvillimin e ekonomisë. Nga ana tjetër, kjo do të ndikonte në thithjen e investimeve të huaja dhe hyrjen e kapitaleve të reja në ekonomi, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e aktivitetit ekonomik të vendit.

### SEMINAR TEKNIK

Departamenti i Kërkimeve, në kuadër të Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, organizon brenda departamentit, Seminarin Teknik. Më poshtë do të gjeni një përmbledhje të seminareve të zhvilluara gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2012.

- i. “Të dhënat mikro: mbledhja dhe përdorimi i tyre nga bankat qendrore”, nga Elona Dushku

Ky seminar kishte për qëllim njohjen me të dhënat mikro, si dhe avantazhin e përdorimit të tyre kryesisht nga bankat qendrore, pasi përbëjnë një element kyç në dizenjimin e projekteve, formulimin e politikave, monitorimin, shënjestrimin dhe matjen e impakteve të tyre. Të dhënat mikro janë të dhëna në nivel ose njësi që sigurohen nga anketa, censuse dhe sisteme administrative, duke dhënë një informacion të detajuar në lidhje me karakteristikat e individëve, ndërmarrjeve, korporatave dhe të zonave gjeografike.

- ii. “Karakteristikat e ndërmarrjeve shqiptare para dhe gjatë krizës”, nga Alban Pllaha.

Në këtë seminar u prezantua një informacion në lidhje me vlerësimin e situatës së ndërmarrjeve shqiptare sipas sektorëve, gjatë periudhës 2007 – 2010. Burimi kryesor i të dhënave të analizuar janë ato të marra nga INSTAT-i, nga Anketa e Ndërmarrjeve si dhe nga anketa të ndërmarra nga Banka Botërore. Disa nga çështjet kryesore ku u përqendrua analiza ishin performanca ndër vite e ndërmarrjeve, karakteristikat kryesore të tyre bazuar kryesisht në numrin e të punësuarve, sektorët ku janë përqendruar pjesa më e madhe e ndërmarrjeve, ecuria e aktivitetit të tyre gjatë kësaj periudhe në terma të vlerës së shtuar dhe të fitimit/humbjeve neto; ndërmjetësimi financiar; si dhe situata e tyre krahasuar me vendet e rajonit, në terma të aktivitetit të ushtruar prej tyre etj.

- iii. “Inflacioni bazë: Aplikimi i një koncepti monetar”, nga Endrit Yzeiraj

Koncepti i inflacionit bazë është i rëndësishëm, pasi lidhet ngushtë me zhvillimin e teorive ekonomike Neo-Kejnesiane, ku inflacioni shihet si zhvillim i pritshmërive afatgjata. Ky seminar kishte si synim prezantimin e dy serive për inflacionin bazë. Seritë janë krijuar duke përdorur dy metoda statistikore. Indeksi i parë krijohet duke bërë përjashtim të përhershëm të komponentëve të caktuar, ndërsa indeksi i dytë krijohet me metodën *trimming*, që konsiston në përjashtimin e ekstremeve të serisë çdo muaj. Ky i fundit ofron një elasticitet pasi lejon ndryshimin e parametrave të tij çdo muaj, duke kontribuar kështu në përmirësimin e indeksit.

- iv. “Guidë mbi përdorimin e bazave të të dhënave online” nga Arlind Rama dhe Enkela Gaçaj

Qëllimi kryesor i këtij seminari ishte njohja kryesisht e të rinjve me bazat kryesore të të dhënave që përdoren për analizimin e zhvillimeve makroekonomike dhe financiare. Në këtë seminar u trajtuan faqet kryesore të disa organizmave ndërkombëtare si OECD, BQE, Banka Botërore, FMN, WTO, Eurostat etj., të përdorura nga kërkuesit shkencorë. Kështu jo vetëm që u paraqitën skematikisht por edhe u konsultua në mënyrë të detajuar informacionet që ato përmbajnë me fokus të veçantë përditësimin e të dhënave, frekuencën si dhe gjatësinë e serive kohore. Ky prezantim kishte si qëllim orientimin e kërkuesve duke mundësuar lehtësimin e gjetjes së të dhënave dhe si rrjedhojë të punës kërkimore.

- v. “Manuali kontabël i bankave të nivelit të dytë” nga Arlind Rama dhe Enkela Gaçaj

Në këtë seminar u bë një trajtim i zgjeruar i parimeve bazë kontabël dhe mënyrës së organizimit të kontabilitetit të bankave të nivelit të dytë në Shqipëri. Vëmendje e veçantë iu kushtua përgatitjes së pasqyrave kryesore financiare prej tyre, me fokus kryesor, bilancin. Duke patur si referencë bazë organizimin e llogarive dhe nënlllogarive në Sistemin Raportues të Unifikuar (SRU), sipas të cilit bankat e nivelit të dytë raportojnë të dhënat financiare në Bankën e Shqipërisë, u analizuan klasat kryesore të llogarive në aktivet dhe pasivet e bilancit tip të bankave të nivelit të dytë.

- vi. “Hyrje në MATLAB”, nga Lorena Skufi

Seminari kishte për qëllim familjarizimin me programin MATLAB, program i përdorur gjerësisht në analizën numerike. Nisur nga fakti që programi përbën laboratorin e matricave, njohja e programit i shërben krijimit të bazave të mëdha të të dhënave dhe përditësimit të tyre, analizave të hollësishme të të dhënave dhe krijimit të modeleve. Programi MATLAB është i përdorur gjerësisht në modelimin dhe aplikimin e modeleve dinamike si DSGE, GAP. Gjatë prezantimit u diskutua mbi strukturën e programit dhe menaxhimin e tij. Më pas u bë demonstrimi i hedhjes së të dhënave sipas katër mënyrave që ofron programi dhe u replikuan funksionet bazike matematike. Në vijim u prezantua kuptimi që mbartin karaktere të veçanta në MATLAB dhe operatorët.

vii. “Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit”, nga Esida Abazaj

Seminari synonte të shpjegonte kuadrin e përdorur nga FMN-ja në analizimin e qëndrueshmërisë së borxhit në raportet vjetore për vende të ndryshme. Ky kuadër mundëson vlerësimin e aftësisë së qeverisë të një vendi për shërbimin e borxhit në kushtet e politikave të ndërmarra. Gjithashtu, kjo analizë lejon politikëbërësit të identifikojnë sektorët ekonomikë që mund të konsiderohen përgjegjës për akumulimin e tepërt të borxhit. Më konkretisht, ky kuadër (i cili konsiston në një model të vogël në Excel) llogarit nivelin e deficitit primar, që nuk lejon rritjen e nivelit të borxhit mbi nivelin aktual në vitet e ardhshme. Seminari u shoqërua me ushtrime praktike dhe me një shembull konkret për rastin e Shqipërisë.

### **KONFERENCA VII VJETORE E SEEMHN, 13-14 DHJETOR 2012, TIRANË**

Konferenca e 7-të vjetore e SEEMHN (*South-Eastern European Monetary History Network*) do të mikpritet nga Banka e Shqipërisë dhe do të zhvillohet në Tiranë, në datat 13-14 dhjetor 2012. Tema e konferencës do të jetë “Rrëfimi i dy krizave: Depresioni i madh dhe Recesioni i madh në Evropën Juglindore (Paralelizma, Administrimi i krizave dhe Ristrukturimi i sektorit bankar)”.

Nicos Christodoulakis (Universiteti i Athinës për Ekonomi e Biznes dhe LSE), Pierre Siklos (Wilfrid Laurier University dhe Viessmann Research Centre) dhe Max Schulze (LSE) kanë konfirmuar

pjesëmarrjen e tyre në konferencë, si folës kryesorë.

Të gjithë ata persona që janë të interesuar të marrin pjesë në këtë konferencë dhe që duan të kontribuojnë në këtë fushë kërkimore, në linkun e mëposhtëm do të gjejnë një informacion më të detajuar mbi aktivitetin dhe termat e referencës.

[http://www.bankofgreece.gr/BoGDDocuments/Call\\_for\\_Papers\\_SEEMHN7thConference.pdf](http://www.bankofgreece.gr/BoGDDocuments/Call_for_Papers_SEEMHN7thConference.pdf)

Afati i fundit për të aplikuar është data 15 nëntor 2012.

*South-Eastern European Monetary History Network* (SEEMHN) është një komunitet historianësh monetarë dhe financiarë, ekonomistësh dhe statistikienësh, i krijuar në prill 2006 me iniciativën e Bankës Qendrore të Bullgarisë dhe Bankës së Greqisë. Objektivi i tij kryesor është të shpërndajë njohuri mbi historinë monetare dhe politikën monetare të Evropës Juglindore, si një pjesë përbërëse e përvojës evropiane. Pjesëmarrësit e Grupit të Punës për Mbledhjen e të Dhënave (*Data Collection Task Force, DCTF*) janë: Banka e Shqipërisë, Banka e Greqisë, Banka Qendrore e Bullgarisë, Banka Qendrore e Republikës së Turqisë, Banka Kombëtare e Rumanisë, Banka Qendrore e Serbisë dhe Banka e Austrisë. Këto shtatë banka qendrore kanë rënë dakord për të dhënë kontributin e tyre për publikimin e përbashkët të një vëllimi të serive kohore afatgjata të harmonizuara të variablave monetarë, financiarë dhe makroekonomikë.

**LINQE:**

Banca d'Italia (<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>)

Banco de Espana (<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>)

Bank of England (<http://www.bankofengland.co.uk/publications/eorkingpapers/index.htm>)

Bank of Finland ([http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit\\_julkaisut/index.htm](http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm))

Bank of Greece (<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>)

Czech National Bank (<http://www.cnb.cz/en/research/>)

Deutsche Bundesbank ([http://www.bundesbank.de/vfz/vfz\\_diskussionspapiere\\_2009.en.php](http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php))

European Central Bank (<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>)

Oesterreichische Nationalbank ([http://www.oenb.at/en/presse\\_pub/research/research.jsp](http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp))

Federal Reserve (<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>)

BIS Central Bank Research Hub (<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>)

International Journal of Central Banking (<http://www.ijcb.org/>)

National Bureau of Economic Research (<http://www.nber.org/>)

International Monetary Fund (<http://www.imf.org/external/pubind.htm>)





Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Avni Rustemi", nr.24, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3

Faks: + 355 4 2419408

E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Tirazhi: 650 kopje

Shtypur në shtypshkronjën AdelPrint